

**VENDIM**  
**Nr.345, datë 29.4.2020**

**PËR PROCEDURAT PËR EMËRIMIN DHE TRAJTIMIN FINANCIAR TË  
NËPUNËSVE TË EMËRUAR NGA INSTITUCIONET E TJERA NË MISIONET  
DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr.23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Emërimi në misionet diplomatike, sipas pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr.23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, bëhet pas koordinimit të ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme me institucionin që propozon nëpunësin, më poshtë referuar si “institucioni dërgues”.

2. Institucioni dërgues propozon emërimin e nëpunësit sipas pikës 1, të këtij vendimi, duke e për zgjedhur atë nëpërmjet procedurave të brendshme të institucionit.

3. Këta nëpunës emërohen nga ministri përgjegjës për punët e jashtme, me propozim të ministrit të institucionit dërgues dhe janë në varësi të dyfishtë, nga kreu i misionit diplomatik dhe titullari i institucionit dërgues.

4. Përshkrimi i punës, hierarkia, mënyra e komunikimit dhe të drejtat e detyrimit e palëve përcaktohen në marrëveshjen e lidhur ndërmjet ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme dhe institucionit dërgues. Marrëveshja duhet të përmbajë:

- a) pozicionin e punës/gradën diplomatike të emërimit;
- b) varësinë e dyfishtë nga kreu i misionit diplomatik dhe titullari i institucionit dërgues;
- c) përshkrimin e punës;
- ç) afatin e punësimit;
- d) të drejtat dhe detyrimet e nëpunësit;
- dh) të drejtat dhe detyrimet e ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme dhe të institucionit dërgues.

5. Nëpunësit do të shërbejnë në misionin diplomatik sipas afatit të përcaktuar në ligjin për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë dhe pas përfundimit të këtij shërbimi do të rikthehen në pozicionin e mëparshëm ose në një pozicion të barasvlershëm me të.

6. Me emërimin e nëpunësve në misionin diplomatik, marrëdhënia e tyre e punës do të rregullohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e punës në shërbimin e jashtëm.

7. Nëpunësit e emëruar në përputhje me pikën 1, të këtij vendimi, trajtohen sipas pagës referuese të gradës diplomatike të emërimit, në përputhje me vendimet e Këshillit të Ministrave, nr.546, datë 11.8.2011, “Për përcaktimin e pagave dhe shtesave mbi pagë të punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja, të atasheve ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr.20, datë 18.1.2017, “Për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në misionet diplomatike dhe postet konsullorë të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit”.

8. Shpenzimet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i institucionit dërgues.

9. Nga zbatimi i këtij vendimi përjashtohen nëpunësit emërimi i të cilëve në misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë rregullohet me akte të tjera nënligjore.

10. Ngarkohen ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe të gjitha institucionet shtetërore, që brenda fushës së tyre të përgjegjësisë dërgojnë nëpunës për t'i emeruar në misionet diplomatike, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**